



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE VLORE
NOTERE ETLEVA B.STAMO FIER

Pulla e Takës
e PAGUAR
ndodhen në aktin e Arkives



Adresa: Lagja "29 Nëntori" Rr.Dervish Hekali", Fier mobil:069 922 4334
Nr. 2257.rep

Nr. 1010.kol

KONTRATE DHURIMI

Në Fier, sot më datë 05.08.2019 (Dymijë e Nëntëmbëdhjetë), përpara meje Notere Etleva B. Stamo, anëtare e Dhomës së Noterëve Vlorë, në zyrën time të ndodhur në Rrugën Dervish Hekali, Lagja 29 Nëntori, qyteti Fier,u paraqiten palët :

1.JAHO NUH ,i biri iXhelal-it , lindur me 24.09.1985 ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar , identifikuar prej meje Noterit nga Leternjoftimi ID me numer 025860856/ I50924102V , ketu ne cilesine e Ortakut te **Shoqerise** « RENT A CAR & TRAVEL » shpk , regjistruar me date 22.05.2019,me zyre qendrore ne Fier,lagja Kongresi i Permetit, rruga jakov Xoxa, zona kadastrale 8532 ,Pallati Intel media, kati i pare numer indentifikimi subjekti L92922401J me status Aktiv - **në këtë kontratë " Pala Dhuruese "** .

2.ERVIS MYRTAJ ,i biri i Teki-ut , lindur me 19.12.1985 ne Kukes,Alb dhe banues ne Fier, madhor me zotesi te plote per te vepruar , identifikuar prej meje Noterit nga Pasaporta numer BF7682421/ I51219003A, ketu ne cilesine e Ortakut te **Shoqerise** « RENT A CAR & TRAVEL » shpk , regjistruar me date 22.05.2019,me zyre qendrore ne Fier,lagja Kongresi i Permetit, rruga jakov Xoxa, zona kadastrale 8532 ,Pallati Intel media, kati i pare numer indentifikimi subjekti L92922401J , me status Aktiv **në këtë kontratë " Pala pranuese e Dhurimit "** .

Të cilët kërkuan redaktimin e kësaj kontratë Dhurimi aksionesh, në përputhje me Ligjin Nr. 7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar nenit 761-767 dhe në përgjithësi të legjislacionit shqiptar në fuqi.

MEQËNËSE:

-Pala dhuruese z. Jaho Nuh ,ortak i shoqërisë « RENT A CAR & TRAVEL » shpk me status Aktiv ,person juridik shqiptar me seli në Fier,lagja Kongresi i Permetit, rruga Jakov Xoxa, zona kadastrale 8532 ,Pallati Intel media, kati i pare numer indentifikimi subjekti L92922401J me kapital themeltar 10.000,00 leke eshte zoterues i 50% te vleres se kapitalit te Shoqerise dhe nepermjete ketij akti noterial i dhuron ortakut Ervis Myrtaj 20% te vleres se kapitalit qe ka ne pronesi ne Shoqerine « RENT A CAR & TRAVEL » shpk Fier.

-Palet kontraktuese transferimin e titilli te pronesise te 20 % te kapitali nepermjete Dhurimit nga pala dhuruese tek pala pranuese e dhurimit e kane miratuar me vendim të ortakeve te shoqerise .

ATEHERE

meqënëse ekzistojne parashtrimet si më sipër, palët bien dakord dhe lidhin këtë kontratë dhurimi si më poshtë:

Neni 1

Objekti i Kontratës

- **Pala dhuruese Jaho Nuh me vullnet te lire e te plote i dhuron ortakut Ervis Myrtaj 20% të vlerës së kapitalit te zotëruar prej tij në shoqërinë «RENT A CAR & TRAVEL » shpk Fier .**

Ervis Myrtaj

Jaho Nuh

Transferimi i pronësisë do të bëhet nga pala dhuruese tek pala pranuese e dhurimit duke kaluar respektivisht titullin e pronësisë të 20% te kapitalit te shoqerise në favor të z. Ervis Myrtaj, i cili e pranon këtë dhurim dhe se bashku me pjesëmarrjen e tij ai bëhet zotërues i 70% te kapitalit te shoqerise dhe ortak i Jaho Nuh ngelet ortak me pjesëmarrje 30 % te kapitalit te shoqerise .

Neni 2.

2.1 Palët bien dakord se pronësia kalon menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2.2 Palët bien dakort se kuotat janë të lira nga çdo pretendim i të tretëve, nuk janë të rënduara me barrë apo të ketë proces gjyqësor në lidhje me pronësinë e tyre, konfirmuar nga rezultati i kërkimit në RBS.

Neni 3.

Regjistrimi në QKB

3.1 Pala pranuese e dhurimit autorizon ortakun Ervis Myrtaj të depozitojë këtë kontratë në QKB, duke shlyer detyrimet e regjistrimit.

Neni 4.

Shpenzimet për përpilimin e dokumentacionit

4.1 Palët bien dakort se pala pranuese e dhurimit merr përsipër kryerjen e shpenzimeve noteriale dhe shpenzimeve të tjera në lidhje me këtë kontratë.

Neni 5.

Të ndryshme

5.1. Kjo kontrate lidhet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Mosmarreshjet qe mund te lindin do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier.

Neni 6.

Hyrja në Fuqi e Kontratës

6.1 Kjo kontrate hyn ne fuqi menjehere me nënshkrimin e saj.

Neni 7.

Pjesët Përbërëse të Kontratës

7.1 Do ti bashkangjiten kësaj kontrate: kopje dokument identifikimi të palëve, ekstrakte QKB,RBS,vendim nr.2 dt 05.08.2019 dhe çdo dokument tjetër janë pjesë përbërëse e kontratës.

Neni 8.

Nënshkrimi i Palëve

8.1 Unë Noteri, pasi i lexoj Palëve me zë të lartë këtë kontratë dhe ata më deklarojnë se e kanë lexuar dhe kuptuar çdo pikë të kësaj kontrate, dhe e nënshkruajnë atë pa rezerva dhe me vullnetin e tyre të lirë ne 4 (tre) kopje të barazvlefshme, nga të cilat një kopje për zyrën e Noterit, ndërsa kopjet e tjera për palët për ti përdorur nga ata.

Une Noteri ne mbeshtetje te ligjit nr. 110/2019 , neni 62 pika"ll" vërtetoj nënshkrimet dhe vullnetin e paleve , e nënshkruaj ,firmos dhe vulos personalisht duke i dhene formen e kerkuar dhe ligjore .

PALA DHURUEESE


PALA PRANUESE E DHURIMIT

Jaho Nuh

Ervis Myrtaj

NOTERE
ETLEVA B. STAMO

Etleva B. Stamo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE
" RENT A CAR & TRAVEL " SHPK

PROCES VERBAL
date 05.08.2019

I MBLEDHJES SE ASMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
" RENT A CAR & TRAVEL " SHPK

Sot, me date 05.08.2019 , ora 9 °°, u mbledh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" shpk e thirrur nga Administratori e perfaqesuesi ligjor i kesaj Shoqerie Jaho Nuh per shqyrtimin e pikave te rendit te dites per sa vijon :

1. Kalimi nepermjet Dhurimit i titullit te pronesise te 20% te vleres se kapitalit te Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" shpk , te zoteruara nga ortaku Jaho Nuh ne favor te ortakut Ervis Myrtaj .

Kjo mbledhje u kerkua nga ortaku Jaho Nuh zoterues i 50% te vleres se kapitalit te Shoqerise " RENT A CAR & TRAVEL " shpk

Pas verifikimit te prezences se ortakeve te shoqerise rezulton se mbledhja e thirrur eshte e ligjshme dhe e vlefshme .

U vendos qe Jaho Nuh te jete Kryetar i kesaj mbledhje pasi dhe eshte dhe Administratori i Shoqerise .Gjithashtu u vendos te kalohej ne rendin e dites .

1. - Kalimi nepermjet Dhurimit i titulli te pronesise te 20% te vleres se kapitalit te Shoqerise " RENT A CAR & TRAVEL " shpk qe zoteron Ortaku Jaho Nuh ne favor te ortakut Ervis Myrtaj .

- Me pas u kalua ne votim nga i cili rezultoi :

- Te dhurohet 20% i vleres te kapitalit te Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" shpk te zoteruara nga ortaku Jaho Nuh ne favor te Ortakut tjeter te Shoqerise Ervis Myrtaj
- Ortaku Ervis Myrtaj pranon dhurimin
- Per te realizuar objektivin e mesiperme duhet te kryhet sipas ligjit kontrata e Dhurimit perpara Noterit .

Meqense pikat e rendit te dites te parashikuara u realizuan pasi nuk pati asnje veretje apo propozim ,mbledhja deklarohet e mbyllur .

ORTAKET

Ervis Myrtaj
Jaho Nuh

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE
"RENT A CAR & TRAVEL" SHPK

V E N D I M
Nr. 2 date 05.08.2019
I ASMBLESE TE SHOQERISE
"RENT A CAR & TRAVEL" SHPK

Sot me date 05.08.2019 u mblodh Asambleja e ortakeve te Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" SHA e thirrur nga **ortaku dhe Administratori** i kesaj Shoqerie Jaho Nuh per shqyrtimin e pikave te rendit te dites per sa vijon :

1. Kalimi nepermjete Dhurimit i titulli te pronesise te 20% te vleres se kapitalit te shoqerise qe zoteron ortaku i kesaj shoqerie Jaho Nuh ne favor te ortakut Ervis Myrtaj .

Pas votimit ortakeve

U VENDOS :

Te dhurohen 20 % i vleres se kapitalit te Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" shpk , te zoteruara nga ortaku Jaho Nuh ne favor te ortakut Ervis Myrtaj duke u bere Ervis Myrtaj ortak i i Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" shpk me pjesemarrje ne 70% te kapitalit te shoqerise dhe Ortaku Jaho Nuh me pjesemarrje ne 30 % te kapitalit te Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" shpk .

- 1- Te kryhet kontrata e dhurimit perpara Noterit .
- 2- Z. Jaho Nuh do te vazhdoje te jete perfaqesuesi ligjor i shoqerise " RENT A CAR & TRAVEL " shpk dhe Ortak me 30 % te kapitalit te Shoqerise .
- 3- Ngarkohet Administratori Jaho Nuh , i biri i Xhelal-it , lindur me 24.09.1985 me numer personal I50924102V , i cili do te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per regjistrimin prane QKB-se te vendimit nr. 2 , dat 05.08.2019 te Asamblese se Shoqerise "RENT A CAR & TRAVEL" shpk dhe kontrates se Dhurimit te kapitalit .

ORTAKET

Ervis Myrtaj

Jaho Nuh

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2019080511426901
Data e Rezultatit të Kërkimit: 05.08.2019
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 11:42:06AM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-116-3986
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

RENT A CAR & TRAVEL SH.P.K.



Armeta Shoku